

Ligjërata nga lënda:

## **Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne**

### Përmbledhje ligjërata (III)

- Pretendimet kryesore të realizmit që lidhen me anarkinë, aktorët shtetëror, arsyeshmërinë dhe dobinë e forcës ushtarake, janë sfiduar duke u mbështetur në shumë argument.
- Liberalët e kundërshtojnë idenë realiste, sipas së cilës interesi vetjak i ngudështë është më i arsyeshëm se sa bashkëpunimi me përfitim të ndërsjelltë.
- Neoliberalizmi argumenton se edhe në një system anarkik me shtete autonome të arsyeshme, bashkëpunimi mund të lindë nëpërmjet krijimit të normave, regjimeve dhe institucioneve.
- Të mirat kolektive janë përfitime që merren nga të gjithë pjesëtarët e një grupi pavarësisht prej ndihmesës së tyre vetjake. Normat e rregullat e përbashkëta janë të rëndësishme për ti bërë pjesëtarët që të paguajnë për të mirat e përbashkëta.
- Regjimet ndërkombëtare, shpresat që përputhen ndërmjet tyre, të udhëheqësve të shteteve lidhur me rregullat për hapsirat e problemeve në MN, ndihmojnë për të krijuar qëndrueshmëri në kushtet e mungesës së një qeverie botërore.
- Sipas teorisë së qëndrueshmërisë hegjemoniste mbajtja e një fuqie mbizotëruese nga një shtet i vetëm, ofron qëndrueshmëri për marrëdhëniet ndërkombëtare e ndihmon për të krijuar regjime.
- Në një grupim të sigurimit kolektiv, një grup shtetesh hyjnë në marrëdhënie që ti përgjigjen së bashku një agresioni; OKB-ja dhe organizata të tjera ndërqeveritare kryejnë këtë rol.
- Studjuesit feminist të MN janë të njëjtë mendim se përkatësia gjinore e njerëzve është e rëndësishme për të kuptuar MN, por ndahen në disa rryma në lidhje me mendimin që kanë për rolin e përkatësisë gjinore.
- Feministët botëkuptimor argumentojnë se ekzistojnë ndryshime reale (jot të paarsyeshme) ndërmjet burrave e grave. Burrat i mendojnë më shpesh marrëdhëniet shoqërore nga pikëpamja e autonomies (siç bëjnë realistët), por grate mendojnë nga pikëpamja e lidhjes.
- Feministët botëkuptimorë argumentojnë se burrat janë mesatarisht më luftarak se sa grate. Megjithëse gra të veçanta pjesëmarrëse (siç janë udhëheqëset e shteteve) mund të mos e pasqyrojnë këtë dallim, pjesëmarrja e një numri të madh grash do ta ndryshonte karakterin e sistemit ndërkombëtar, duke e bërë atë më paqësor.
- Feministët liberal nuk janë të një mendimi se grate kanë aftësi ose prirje thelbësisht të ndryshme si pjesëmarrëse të MN. Ata argumentojnë se grate janë të barabarta me burrat në pothuaj në të gjitha rolet e MN. Si prova, feministët liberal paraqwsin udhëheqëset femra ose ushtarake të së kaluarës e të së sotmes.
- Kritikët postmodernë e hedhin poshtë të gjithë strukturën e gjuhën e realizmit, së bashku me aktorët e saj shtetëror të vetëm. Postmodernistët argumentojnë se asnjë koncept i thjeshtë nuk mund të kapë thelbin e realiteteve të shumëfishta të përjetuara nga pjesëmarrësit e MN.

- Feministët postmodern kërkojnë të zbulojnë nëntekstet që lidhen me përkatësinë gjinore, të cilat gjenden të nënkuptuara në diskutimet e realistëve, përfshirë temat seksuale që lidhen me konceptin e fuqisë.
- Konstruktivistët i hedhin poshtë hamendjet realiste për interes shtetërorë, duke e lidhur pjesërisht lindjen e këtyre interesave me rregullat e normat ndërkombëtare.
- Programet e studimeve për paqën janë ndërdisiplinore dhe kërkojnë të zgjerojnë studimin e sigurimit ndërkombëtar duke përfshirë në të edhe faktorët ekonomik shoqëror të lënë pasdore prej realizmit.
- Studimet për paqe e pranojnë një prirje normative, sipas së cilës paqa është e mire e lufta është e keqe, e një gatishmëri për ta vënë teorinë në zbatim duke marrë pjesë në politikë.
- Ndërmjetësimi e forma të tjera të zgjidhjes së konfliktit janë mjete alternative të ushtrimit të ndikimit mbi pjesëmarrësit në përpjekjet për marrëveshje. Këto mjete janë duke zëvendësuar gjithnjë e më shumë procesin e zgjidhjes së konflikteve pa përdorim (ose pa përdorim më) të dhunës.
- Për studiuesit e paqës, militarizmi në shumë kultura ndihmon për nxitjen e prirjes së shteteve për përdorimin e dhunës në përpjekjet ndërkombëtare për marrëveshje.
- Paqja e mirë nënkupton jo vetëm mungesën e luftës, por trajtimin e kushteve që studiuesit e paqës i lidhin me dhunën, sidomos të padrejtësisë e varfërisë.
- Lëvizjet për paqe mundohen të ndikojnë mbi politikën e jashtme të shteteve në lidhje me forcën ushtarake; të tilla lëvizje kanë interes të madh për studimet për paqën.
- Mosushtrimi i dhunës, mohimi i forcës, mund të jetë një mjet veprues ndikimi, sidomos për njerëzit e varfër e të shtypur që kanë pak mjete të tjera për të vënë në përdorim.

Terma të rëndësishëm:

Neoliberalizëm, Tit for tat, Problemi i së mirës kolektive, Përfitues pa detyrime, Regjim ndërkombëtar, Sigurim kolektiv, Feminizëm botëkuptimor, Feminizëm liberal, Feminizëm postmodern, Postmodernizëm, Konstruktivizëm, Militarizëm, Paqe e mire, Qeveri botërore, Pacifizëm etj.